



02Nr. 9617 /2023  
09.11.2023

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-197, neni 80 dhe neni 81 , Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimin Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm , Komuna Hani i Elezit rishpallë:

### KONKURS

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës)

Institucioni: **Komuna Hani i Elezit**

Drejtoria: **Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

1. Titulli i vendit të punës: **Asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta**

njësia/ sektori: **Një (1) pozitë SHFMU “Ilaz Thaçi” Hani i Elezit**

Numri i pozitave: **(1) pozita me afat të pacaktuar**

Koeficienti/Grada: **E-22/5**

Orët e punës: **20 orë në javë**

#### **Detyrat dhe roli i Asistenti/ës për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore :**

- Ndihmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- Punon me mësuesin dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndët të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve.
- Përgadit materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgaditë informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve.
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës.
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike/personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre.
- Promovon bashkëpunim shkollë-shtëpi, mbështet dhe diskuton qeshtje të njeshme me prindin/kujdestarin.
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve.
- Informacionet në shkollë i trajtojnë si plotësisht konfidenciale.

#### **Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Niveli 5-të (post-sekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

**Dokumentet e nevojshme:**

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje ).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jene kopje vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata )
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

**Afati dhe mënyra e aplikimit:**

**Pranimi i aplikacioneve bëhet mbrenda tridhjetë ( 30) ditëve nga data 09.11.2023 deri 08.12.2023 (16:00).**

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriterete konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

**Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.**

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> në web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.

**Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi**

